


Nenad Peroshiq
Milosh Vukanoviq

Propaganda gjatë Luftës së Dytë Botërore





Pyetja kyçe

Deri në cilën masë propaganda i realizoi (me sukses) qëllimet e veta gjatë Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi?

Tema

Tema e punëtorisë janë pllakatet propagandistike të fraksioneve të ndryshme në Jugosllavi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Punëtorja e përfshinë vetëm një pjesë të pllakateve, disa fraksione të cilat ishin aktive në territorin e Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pllakatet dhe pamfletet ishin mënyrë e mirë për t'u shprehur qëndrimet e atëhershme politike dhe ideologjike të fraksioneve të ndryshme si edhe qëllimet e tyre. Propaganda kryesisht bën promovimin, kështu që e vërteta e një fraksioni të caktuar është e vetme dhe e patjetërsueshme. Disa mesazhe të këtyre pllakateve janë në përdorim edhe sot e kësaj dite.

Qëllimet

Nëpërmjet qasjes së drejtpërdrejtë me burimet historike, nxënësit do të pajisen me dituri të reja për Luftën e Dytë Botërore. Do t'i kuptojnë më mirë disa mesazhe dhe simbole të asaj kohe, si edhe të metodave propagandistike të fraksioneve të ndryshme. Mesazhet dhe simbolet të cilat janë prezantuar në këto pllakate janë universale për tërë Evropën e asaj kohe.

Rezultatet e mësimit

1. Nxënësit do të pajisen me dije për një pjesë të propagandës të disa fraksioneve në territorin e Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.
2. Nxënësit do të fitojnë dije themelore për propagandën.
3. Nxënësit do t'i analizojnë burimet historike.
4. Nxënësit do t'i vlerësojnë dallimet dhe ngjashmëritë e mesazheve dhe simboleve të fraksioneve të ndryshme.
5. Nxënësit do t'i interpretojnë burimet dhe do të bëjnë analizë të mesazheve të cilat i dërgojnë burimet dhe cilat janë qëllimet e tyre.



HYRJE

Propaganda dhe pllakatet politike

Nën shprehjen propagandë kuptohet ndikimi në vetëdijen njerëzore dhe emocionet, me qëllim që me anë të komunikimit të veçantë të ndryshohen qëndrimet e personave, grupeve ose popujve të caktuar. Propaganda u drejtohet arsyes dhe ndjenjave që popujt ose grupeve të caktuara ndjenjat e të cilëve janë zgjuar, t'i përvetësojë jo vetëm momentalisht por për një periudhë më të gjatë. Prandaj mesazhi duhet të jetë i fuqishëm, mbresëlënës dhe i mbjellë në mënyrë afatgjatë në vetëdije.

Propagandën mund ta definojmë edhe si përpjekje që të ndikohet te një numër sa më i madh që ata të detyrohen ta ndryshojnë mendimin, ose ta mbajnë, që të veprojnë në mënyrë të caktuar. Njëri prej llojeve të propagandës janë edhe pllakatet.

Pllakati bashkëkohor politik u krijua gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore kur luajti një rol të madh në komunikimin e shteti me popullin. Pllakati së pari e inkurajonte atdhedashurinë dhe moralin kombëtar.

Të gjitha mesazhet janë shkruar me shkronja të mëdha, të dallueshme, ndërsa fotografitë janë të fuqishme dhe mbresëlënëse, me ngjyra të gjalla, që të lënë përshtypje sa më të fuqishme.

Pllakati politik kishte detyrat vijuese: demaskimin e armikut (të jashtëm dhe të brendshëm), edukimin e popullsisë së vendit me urrejtje ndaj armikut, motivimin e rezistencës së popullit ndaj armikut, theksimin e obligimeve qytetare.

Pllakatet përdorshin që popullsisë, te e cila nuk kishte mundësi të ndikohet në mënyrë tjetër, t'i dërgohet mesazh. Në Jugosllavi në këtë periudhë kishte mjaft popullsi analfabete dhe gjysmanalfabete dhe drejtimi me anë të pllakatit ishte mënyra e vetme që mesazhi të arrijë edhe deri te ata.

Karakteristikë e rëndësishme e pllakatit, të cilën nuk e kanë llojet tjera të propagandës, është koha e zgjatur e të drejtuarit në territor të gjerë.

Ajo të cilës i kushtohet vëmendje e posaçme është edhe vendi i shpalljes së pllakatit. Më shpesh këto ishin punëtoritë e zejtarëve, tregtarëve, hotelierëve, ndërtesat e administratës shtetërore, kafenetë, kinematë, hotelet, libraritë.

Udhëzime për mësimdhënësin:

Në fillim të orës mësimdhënësi e fillon punëtorinë me pyetje për inicim të ideve, duke i pyetur nxënësit me pyetje vijuese për propagandën:

1. Çka është propaganda sipas jush?
2. Cilat forma të propagandës ekzistojnë sot?
3. Cilat mund të ishin format e para të propagandës?

Pas inicimit të ideve mësimdhënësit ua jep nxënësve ta lexojnë hyrjen.

Aktiviteti 1

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 4 grupe. Mësimdhënësi ka 5 lloje të pllakateve (**pro gjermanë, antikomuniste, antialeate, antipartizane, pro partizane**), por nuk u tregon nxënësve cilit lloj cili pllakat i takon. Mësimdhënësi i përzier pllakatet dhe ia jep secilit grup që të zgjedh 5 pllakate të rastësishme. Secili pllakat ka sqarim të shkurtër. Mësimdhënësi mund të zgjedhë a do t'u japë sqarimet për shfrytëzim. Profesori gjithashtu u jep nxënësve pyetje të cilat do t'u ndihmojnë gjatë analizës së pllakateve.

1. Çfarë mesazhe jep pllakati?
2. Cilat simbole janë të pranishme (nëse ekzistojnë) në pllakat?
3. Cilat emocione i stimulon pllakati?
4. Cilit fraksion i takon pllakati?

Derisa nxënësit e analizojnë pllakatin, mësimdhënësi e vizaton tabelën e dhënë më poshtë në dërrasën shkollore.

Pllakate pro gjermane	Pllakate antikomuniste	Pllakate antialeate	Pllakate antipartizane	Pllakate pro partizane

Pasi që nxënësit t'i analizojnë pllakatet, secili grup jep sqarim të shkurtër për secilin prej 5 pllakateve të cilat i kanë fituar. Në fund e ngjisin pllakatin në kolonën në të cilën mendojnë se bën pjesë.

Në fund të Aktivitetit 1, mësimdhënësit organizon diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet në mesazhet dhe simbolet e secilit lloj të pllakateve.

Aktiviteti 2.

Secili grup i nxënësve duhet të vizatojë pllakatin e vet pro aleat, duke i shfrytëzuar mesazhet dhe simbolet për të cilat mendojnë se janë më të rëndësishme për llojin e tillë të pllakateve. Secili grup duhet ta prezantojë punën e tij dhe t'i sqarojë mesazhet dhe simbolet të cilat shfrytëzohen në vizatim.

Mësimdhënësi mund ta mbarojë punëtorinë me diskutim dhe krahasim të propagandës gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kohës së sotme.



45
minuta



Pllakat pro gjerman nga Serbia
 22.6.41 Përvjetori i luftës evropiane për liri
 Evropa sërish e mbron kulturën e saj nga mësymja e
 lindjes
Arhiva zemaljskog muzeja, Sarajevo



Pllakat pro gjerman nga Kroacia
 MBROJTJE Kroacia mund të gjejë vetëm në anën
 e Gjermanisë
*Katalog izlozbe Svjedoci dubrovske povijesti 1918-1995,
 Dubrovnik, 2010*



Pllakat pro gjerman nga Kroacia
 BOLSHEVIZMI gjithashtu do të ishte fund për ne
 kroatët
 Nga ai mund të na shpëtojë vetëm Gjermania dhe
 lufta e përbashkët
*Katalog izlozbe Svjedoci dubrovske povijesti 1918-1995,
 Dubrovnik, 2010*




Pllakat antikomunist nga Serbia
 Gjermani është murri i vetëm i besueshëm kundër
 bolshevizmit
*Kosta Nikolić, Nemački ratni plakat u Srbiji 1941-1944, Nova
 Pazova, Bonart, 2000, str. 74*



Pllakat antikomunist nga Serbia

Çdo gjë përmbi supet e tua serb.
Takim miqësor i dy serb ngrënësve. (Tito dhe Stalini)

Kosta Nikolić, Nemački ratni plakat u Srbiji 1941-1944, Nova Pazova, Bonart, 2000, str. 74



Pllakate antikomuniste nga Kroacia

Nënnjeriu (komunist me origjinë aziatike)

Narodni muzej Crne Gore, Arhiv, Zbirka dokumenata NOB-a



Pllakat antikomunist nga Kroacia

Çka të pëlqen më shumë: Puna e qetë apo dhuna bolshevike!

Katalog izložbe Svjedoci dubrovačke povijesti 1918-1995, Dubrovnik, 2010



Pllakat antikomunist nga Sllovenia

Banditët ia përgatisin rrugën bolshevizmit
Ikni nga këta nënnjerëz!

<https://sites.google.com/site/mycollectionofposters/propaganda/world-war-ii/slovenia> (27.05.2013, 15:38)



Pllakat kundër aleatëve nga Sllovenia:

Evropa bolshevike

JALTA: VDEKJA E POPUJVE

<https://lh3.googleusercontent.com/-u2jrF3AAwCM/T2DSVWRVpCI/AAAAAABM3g/KiPRy2hpXUc/s1600/D21.jpg>

(27.05.2013. 18:10)




Pllakat kundër aleatëve nga Serbia:

Anglosaksonët edhe për herë të dytë i tradhtuan serbët

<https://lh6.googleusercontent.com/-jIno60PMdbQ/T2DSQo87eNI/AAAAAABM2g/mRP8lo3vaxk/s1600/D10.jpg>

(27.05.2013. 18:10)



Pllakat antialeat nga Sllovenia:

SHBA-ja e bekon Evropën

<https://lh4.googleusercontent.com/-J3Vq7DLPmt4/T2DSTTPuEhI/AAAAAABM24/tSmDxqANV6o/s1600/D15.jpg>


(27.05.2013, 17:49)



Pllakat antialeat nga Serbia: PSE?

Beograd 16-17.IV.1944 (Dita e bombardimeve intensive të Beogradit)

Kosta Nikolić, Nemački ratni plakat u Srbiji 1941-1944, Nova Pazova, Bonart, 2000, str. 37



Pllakat antipartizan nga Sllovenia,
DEVOCIONI PARTIZAN

<https://lh3.googleusercontent.com/-u2jrF3AAwCM/T2DSVWRVpCI/AAAAAABM3g/KiPRy2hpXUc/s1600/D21.jpg>
(27.05.2013. 18:10)



Pllakat antipartizan nga Sllovenia
Feja e juaj është në rrezik

<https://lh6.googleusercontent.com/-jIno60PMdbQ/T2DSQo87eNI/AAAAAABM2g/mRP8lo3vaxk/s1600/D10.jpg>
(27.05.2013. 18:10)



Pllakat antipartizan nga Serbia
“Çlirimtar?” JO, ASNJËHERË...

Arhiva zemaljskog muzeja, Sarajevo




Pllakat antipartizan nga Serbia
Serbia është në frontin antikomunist

Kosta Nikolić, Nemački ratni plakat u Srbiji 1941-1944, Nova Pazova, Bonart, 2000, str. 37



Pllakat pro partizan nga Sllovenia
 Për goditjen e fundit
 TË GJITHË!
<https://lh6.googleusercontent.com/-W6bqxTRshcY/T2DScDpt2wI/AAAAAABM5k/Eu6PC45Kgy0/s1600/P13.jpg>
 (27.05.2013 18:20)



Pllakat pro partizan nga Kroacia
 Të gjithë në luftë për lirinë e KROACISË!
http://commons.wikimedia.org/wiki/File:Partizanski_plakat.jpg
 (27.05.2013 18:20)



Pllakat pro partizan nga Sllovenia
 Të gjithë ti marrim armët në dorë!!
<https://lh4.googleusercontent.com/-BSFkwTEVYfo/T2DSgpsZrkl/AAAAAABM7A/x9uG92fhJK4/s1600/mmsblog0001702jk0.jpg> (27.05.2013 19:40)



Pllakat pro partizan nga Sllovenia
 Ushtria e kuqe e mirëseardhur në tokat tona!
<https://lh6.googleusercontent.com/-GHseRG121Ps/T2DSezi6i0I/AAAAAABM6I/rmoXufg5Niw/s1600/P20.jpg>
 (27.05.2013 19:40)